



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 92/2017

Prishtinë, më 28.3.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviç, zëvendëskryetar i dytë, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi dhe Blerim Grainca, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Rrustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

E ftuar: Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Gazmed Mejzini dhe Rexhep Bllaca – MTI; Musa Shabani, Kemajl Zeqiri dhe Azem Rexhaj –KPM; Dukagjin Shala (ekspert i pavarur), Kreshnik Kurtishi dhe Liridon Shurdhani –USAID/ PFD; Etleva Malushaj – LVV; Agron Avdyli dhe Arianit Berisha – GP/LDK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina, Veton Raci dhe Nuri Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.3.2017;
- 3.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare;
- 4.Shqyrtimi i nismës legjislative “Projektligji për miniera dhe minerale”;
- 5.Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.3.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 21.3.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare

Kryetari, tha se kësaj pike të rendit të ditës i kemi dhënë prioritet, që ta përshpejtojmë në shqyrtim këtë projektligj, pasi që kemi rekomandim nga raporti i Bankës Botërore që të lehtësohen dhe të shkurtohen procedurat e të bërit biznes. Për ta paraqitur Projektligjin për shoqëritë tregtare, si sponsores, e kemi të ftuar znj. Hykmete Bajramin, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, të cilës ia dha fjalën për të paraqitur ekspozë për projektligjin në fjalë.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, e paraqiti Projektligjin nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare, në mënyrë kronologjike. Projektligji për shoqëritë tregtare është paraparë në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), Planin e punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017. Arsyeja e parë për hartimin e Projektligjit për shoqëritë tregtare është adresimi i nevojës për përafrimin e ligjit ekzistues për shoqëritë tregtare me legjislacionin e BE-së, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe Planit të Zbatimit për MSA-në. Arsyeja e dytë për hartimin e Projektligjit për shoqëritë tregtare është përcaktimi i rregullave që ndikojnë në mbrojtjen e investitorëve të vegjël në korporata, si dhe përmirësimi dhe thjeshtësimi i mëtutjeshëm i procedurave për regjistrimin e shoqërive tregtare, duke u bazuar në kërkesat e metodologjisë së Bankës Botërore në raportin e të bërit biznes, respektivisht indikatorët, fillimi i një biznesi dhe mbrojtja e investitorëve të vegjël. Me këtë projektligj, është krijuar baza ligjore për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të raportimit të performancës së regjistrimit të shoqërive tregtare, si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me azhurnimin e të dhënave në fushën e mirëmbajtjes dhe regjistrimit të bizneseve. Sipas dispozitave të projektligjit, shoqërive tregtare, të cilat regjistrohen në ARBK, iu jepet një numër unik, i cili identifikon shoqëritë tregtare. Duke pasur parasysh se projektligji i propozuar është hartuar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane, ministrja Bajrami i propozoi komisionit, që ta shqyrtojë dhe miratojë këtë projektligj.

Kryetari, theksoi se është me rëndësi që Projektligji për shoqëritë tregtare, i dedikohet më shumë MSA-së dhe direktivave të BE-së. Po ashtu, risi është regjistrimi elektronik, regjistrimi i bizneseve të vogla, si dhe qeverisjen e korporatave. Me anë të ndryshimeve të propozuara për qeverisjen e korporatave, duhet të shohim, sepse janë dispozita në një masë paksa më të ndërlikuar. Pasi që është paraparë miratimi i disa udhëzimeve administrative, të cilat do të plotësojnë dispozitat ligjore dhe që do të bartin parimet e lehtësimit të regjistrimit të shoqërive tregtare dhe reduktimit të barrierave ndaj të bërit biznes, duhet ta ndërlidhim mungesën e bazës ligjore në ligjin ekzistues, sepse do të kishte paraqitur vështirësi gjatë zbatimit. Te regjistrimi i bizneseve, duhet të kemi identifikimin e identitetit të personit, qoftë fizik apo juridik. Këtë identifikim duhet ta shohim e ta bëjmë përmes noterit dhe pastaj të regjistrohet si biznes, në

kundër të MTI-së. Kjo procedurë e verifikimit është mirë të bëhet, për të parandaluar regjistrimin e bizneseve fiktive.

Besim Beqaj, tha se Projektligji për shoqëritë tregtare është esencial. Deri në leximin e dytë, do të kemi kohë të mjaftueshme për t'i dhënë një kujdes më të veçantë gjatë shqyrtimit, pasi që ky projektligj ndërlidhet me shumë ligje tjera. Te përkufizimet, nuk është definuar se çka është “ndërmarrje”, prandaj duhet ta kemi një definim më të qartë. Përkufizimi i termit “Anëtar i familjes”, ku përfshin bashkëshortin/en, prindin, vëllain, motrën, fëmijën apo nipin/mbesën, vëllain, motrën, prindin apo bashkëshortin e cilitdo prej pikës së sipërme; ose çdo person që jeton në të njëjtën shtëpi, duhet të harmonizohet me ligjet tjera, pasi që përfshin një rreth të gjerë të familjes, prandaj, te përkufizimet, duhet të kemi kujdes më të madh. Ndërsa, lidhur me çështjen e ngritur, që u propozua nga kryetari, për verifikimin e personit, qoftë fizik apo juridik që e regjistron biznesin, që ta verifikojë noteri, para se të regjistrohet në MTI, për këtë duhet ta bëjmë një analizë më të detajuar, pasi që mund të krijojmë një barrierë më të ndërlikuar.

Raif Qela, theksoi se është vështirë që sot të japim fjalën për përmbajtjen e këtij ligji kaq voluminoz. Megjithatë, duke pasur parasysh edhe shkaqet se, pse është bërë ky ligj, duhet ta mirëpresim atë, në mënyrë që t'i plotësojmë zbrazëtitrat, të cilat me kohë kanë ndryshuar në terren dhe ta bëjmë harmonizimin e ligjeve tona me legjislacionin evropian, si qëllim dytësor. Që të ketë ligje të mira duhet që përkufizimet të jenë të sakta. Në këtë projektligj, unë shoh se ka pak terma të përkufizuara dhe është shumë problem që në këtë ligj, kaq vëllimor, të mos ketë më shumë terma, të cilët duhet të shpjegohen, sepse është fushë mjaft e rëndësishme e jetës së secilit. Përkufizimet që nuk janë, të futen këtu dhe përkufizimet ekzistuese të precizohen, p.sh. në “ortakëri”, thuhet “ortakëri e përgjithshme ose ortakëri e kufizuar e regjistruar në Kosovë” dhe askund nuk ka shpjegim si përkufizim i “ortakërisë së përgjithshme edhe asaj të kufizuar”, e kjo për bindjen time tregon se kjo duhet të korrigjohet, në mënyrë që ky ligj të bëhet i plotë. Këtë projektligj duhet ta miratojmë në parim dhe pastaj gjatë fazës së amendamentit ta shohim se ku janë zbrazëtitrat.

Blerim Grainca, tha se po e shohim se Projektligji për shoqëritë tregtare i ka 3-4 efekte për çështjet që e bëjnë lehtësimin e të bërit biznes. Futja e regjistrimit elektronik për regjistrim të bizneseve, është një lehtësimi i madh për të gjithë ata që kanë interesim për të bërë biznes, qoftë vendorë apo ndërkombëtarë. Lidhur me nenin 24, Përfaqësuesi i autorizuar, ku çdo “shoqëri tregtare duhet të ketë së paku një përfaqësues të autorizuar” për këtë nen duhet ta kemi një rregullim më të qartë dhe gjatë diskutimeve në vazhdim, deri në lexim të dytë, duhet ta rregullojmë. Ai theksoi se në parim e përkrah miratim e projektligjit.

Sala Berisha- Shala, tha se Projektligji për shoqëritë tregtare ka ardhur në kohën e duhur dhe besoj që do t'i rregullojë disa çështje të rëndësishme, sidomos në lehtësimin e procedurave për të bërë biznes. Ndërsa, lidhur me propozimin që, para se të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, që është në kuadër të MTI-së, të verifikohen te noteri, kjo procedurë do të bëjë një siguri më të madhe, për të parandaluar regjistrimin e bizneseve fiktive.

Kryetari, lidhur me përkufizimet, tha se do t'i shohim se si t'i rregullojmë gjatë shqyrtimit në grupin e punës. Ndërsa, për noterizimin e dokumenteve për regjistrim të bizneseve tek noteri, që e përmenda, këtë propozim e bëra me qëllim të mirë, që të mos ketë njerëz dhe pronarë të

bizneseve fiktive, në mënyrë që të parandalojmë këto dukuri negative. Pra, duhet të jenë të vërtetë ata persona fizikë dhe juridikë që regjistrojnë biznese, mirëpo nëse e shohim se shkakton barrierë, atëherë mund ta shikojmë se si ta rregullojmë më mirë.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, lidhur me çështjen e verifikimit të noterit, të dokumenteve për regjistrim të biznesit, potencoi se do ishte e rrugës, së pari, regjistrimi online dhe në regjistrimin elektronik kemi paraparë nënshkrimin e personit, i cili aplikon për regjistrim të biznesit dhe verifikimi bëhet përmes numrit personal dhe nuk mund të ketë individë fiktivë në regjistrimin e biznesit. Për përkufizimin “Anëtar i familjes”, është bërë në këtë mënyrë dhe formë, për t’ju ndihmuar investitorëve të vegjël për një rreth më të gjerë të familjes. Po ashtu, Projektligji për shoqëritë tregtare, parashih publikimin e të gjitha statistikave të regjistrimit të bizneseve, ndërsa regjistrimi online, është bërë për të krijuar kushte më të mira, në favor të bizneseve.

Besim Beqaj, theksoi se në nenin 27, flitet për “Emri tregtar dhe Marka tregtare”, andaj duhet të definohen se çka janë, ndërsa në nenin 28 “Emri zyrtar dhe Emri tregtar”, nuk ka shpjegim dhe këto emërtime duhet të sqarohen te neni i përkufizimeve. Ndërsa, lidhur me përkufizimin “Anëtar i familjes”, duhet të shikohet se si është rregulluar në Ligjin për familje. Duhet që më hollësisht të ceket familja, se pastaj ka implikim në trashëgimi.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, sqaroi se mungojnë, te përkufizimi “Emri tregtar”, por varet prej pronarit se a do të regjistrojë me emër zyrtar apo emër tregtar. Përkufizimet që mungojnë mund të rregullohen gjatë shqyrtimit në mes të dy leximeve. Ne, si ministri, jemi të hapur ndaj propozimeve që vijnë nga deputetët.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare.*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare.*
- 3. Komisioni vendosi që grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Muhamet Mustafa kryesues, Glauk Konjufca, Sasha Milosavljeviç, Besim Beqaj, Sala Berisha - Shala dhe Blerim Grainca, anëtarë.*

Kryetari, duke marrë parasysh se ky ligj duhet të ketë prioritet, në mënyrë që të mbërrijmë raportin për “Doing bussiness”, propozoi që shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare, të bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale, të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit, dhe atë si vijon:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare, të bëhet në seancën plenare, më datë 30 mars 2017.

2. Deputetët mund të parashtrojnë amendamente, më së largu deri më datë 10 prill 2017.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare, nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Komisionet e përhershme, duhet të përfundojë, më së largu deri më 25 prill 2017.
4. Shqyrtimi i dytë Projektligjit nr. 05/L-158 për shoqëritë tregtare, të bëhet në seancën plenare, jo më vonë se më datë 11 maj 2017.

Komisioni miratoi propozimin e kryetarit.

4. Shqyrtimi i nismës legislative "Projektligji për miniera dhe minerale"

Kryetari, lidhur me këtë pikë, tha se grupi punues e ka hartuar Projektligjin për miniera dhe minerale, brenda afatit, pra sipas rekomandimit të Kuvendit, brenda tremujorit të parë dhe për këtë e përgëzoi grupin e punës, të udhëhequr nga Sala Berisha – Shala. Për ta paraqitur ekspozenë e punës për hartimin e projektligjit, fjalën ia dha znj. Sala Berisha- Shala, kryesuese e grupit të punës.

Sala Berisha- Shala, theksoi se nisma legislative e Projektligjit për miniera dhe minerale, është përkrahur nga komisioni. Pas procesit të monitorimit të zbatimit të ligjit nëpër institucionet përgjegjëse, që kemi bërë vitin e kaluar, kemi gjetur disa të meta që po vështirësojnë zbatimin e ligjit në praktikë, prandaj kemi ardhur në përfundim se duhet të fillohet kjo nisme legislative për Ligjin për miniera dhe minerale. Deputetja Berisha-Shala, pastaj në mënyrë kronologjike e prezantoi punën e grupit punues, si vijon: fillimisht, draft fillestar kemi marrë ligjin në fuqi, me tekst të konsoliduar dhe të gjeturat apo zbrazëtirat në raportin e monitorimit të zbatimit të ligjit; kemi organizuar punëtori dyditore, punëtori e cila ka qenë shumë e frytshme, në të cilën kanë marrë pjesë KPMM-ja dhe MZHE-ja dhe OJQ - INDEP, ku është shqyrtuar projektligji dhe ku janë dhënë propozimet për plotësimin dhe ndryshimin e draftit fillestar. Më pas, është organizuar një tryezë në bashkëpunim me INDEP-në, me temën: "Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të minierave dhe mineraleve – Projektligji i ri për miniera dhe minerale", ku të gjitha propozimet dhe vërejtjet që i kemi marrë nga institucionet përgjegjëse dhe palët e interesit, i kemi inkorporuar gjatë hartimit të Ligjit për miniera dhe minerale. Gjithashtu, kemi pasur të angazhuar ekspert të kësaj fushe, z. Dukagjin Shala. Po ashtu, theksoi se në përgjithësi, është bërë një punë e mirë në këtë fazë dhe para jush ua kemi proceduar për ta shqyrtuar dhe miratuar këtë nisme legislative dhe mandej të procedohet tutje në Kryesi dhe Qeveri për mendim.

Raif Qela, tha se e kemi një nismë legislative shumë të rëndësishme. E vetmja çështje që nuk është shtruar këtu është renta minerare, përkatësisht pjesa e rentës minerare që duhet t'i kthehet komunitetit dhe propozoi që të rregullohet, sikurse në Ligjin për Trepçën. Z. Qela, po ashtu, propozoi që t'i jepet afat dy apo tri ditë, që të përmirësojë gabimet drejtshkrimore, si dhe bëri disa propozime me shkrim, që po të miratohen, do ta përmirësojnë ligjin.

Komisioni e miratoi propozimin e z. Qela.

Kryetari, tha se tani ne jemi në fazën kur duhet ta procedojmë nismën legislative për Projektligjin për miniera dhe minerale, në Kryesinë e Kuvendit, në mënyrë që, pastaj, Kryesia e

Kuvendit ta procedojë në Qeveri, që të japë opinionin e saj. Ai propozoi që te neni 59, të shtohet një paragraf i ri, sikurse në Ligjin për Trepçën, ndërsa nëse kemi kundërshti nga Qeveria, atëherë e amendamentojmë.

Besim Beqaj, tha se Ligji për Trepçën është ligj special, ndërsa edhe për ta miratuar, me propozim të kryetarit, duhet ta ndryshojmë Ligjin për menaxhimin e financave publike, në të kundërtën, ky propozim nuk do të ketë efekt.

Komisioni e miratoi propozimin e kryetarit.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet nisma legislative “Projektligji për miniera dhe minerale”.*
- 2. Nisma legislative “Projektligji për miniera dhe minerale” i dërgohet Kryesisë së Kuvendit për procedim të mëtejshëm, në pajtim me nenin 53, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit.*

5. Të ndryshme Çështjet vijuese

Fatmir Rexhepi, propozoi që brenda kësaj jave, të ftohen përfaqësuesit e Zyrës së Rregullatorit për Energji, që të na njoftojnë lidhur me ndryshueshmin e tarifave për energji elektrike.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Rexhepi.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa